



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1827 Prot.

Datë 30. 12.2016

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Divjakë

Drejtuar: Z. Fredi KOKONESHI
Kryetar
Bashkia Divjakë

Për dijeni: Bashkimi i Operatorëve ekonomik Atelier 4 shpk & Instituti i Politikave Publike dhe Private
Adresa: Rr. Sami Frashëri, Pallati TID Ballkan, Shk. 1/2

I nderuar Z. Kokoneshi,

Në vijim të shkresës Tuaj, Nr. 4960 Prot., datë 16.12.2016, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Territorit me Nr. 1827 Prot., datë 19.12.2016, me lëndë: "Për pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë të PPV-së", dhe botimit të dokumenteve të PPV-së së Bashkisë Divjakë në Regjistrin e Integruar të Territorit, më 16-21.12.2016, AKPT ka kryer kontrollin e përputhshmërisë sipas legjislacionit të planifikimit dhe atij sektorial.

Në bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, janë shqyrtuar në detaje propozimet për zhvillime në territorin e Parkut Kombëtar "Divjakë-Karavasta", pjesë të Bashkisë Divjakë.

Sipas VKM Nr. 687, datë 19.10.2007, "Për shpalljen, me sipërfaqe të zgjeruar, të ekosistemit natyror Divjakë-Karavasta "Park Kombëtar"" si dhe sipas Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjakë-Karavasta" të miratuar me Urdhër Nr. 782, datë 30.12.2015, "Për miratimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar të ekosistemit natyror Divjakë-Karavasta", është përcaktuar zonimi i Parkut Kombëtar, i ndarë në katër nënzona ruajtjeje e administrimi:

- Zona qendrore (ZQ) – shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar;
- Zona e përdorimit të qëndrueshëm (ZPQ) – shkalla e tretë e mbrojtjes;
- Zona rekreative (ZR) – shkalla e katërt e mbrojtjes;
- Zona e përdorimit tradicional (ZPT) – shkalla e pestë e mbrojtjes, ku ndërtimet mund të ushtrohen vetëm pasi të jenë pajisur me leje mjedisi.

Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë duhet të qendrojë brenda kornizës së veprimtarive të lejuara nga VKM e shpalljes së Parkut Kombëtar dhe Urdhërit për miratimin e Planit të Menaxhimit, dhe të respektojë shkallët e mbrojtjes së territorit sipas saj dhe Ligjit për Zonat e Mbrojtura.

Për të qënë në përputhje me këtë legjislacion sektorial, në PPV-në e Bashkisë Divjakë, duhet të reflektohen ndryshimet e mëposhtme në Rregulloren e PPV-së dhe hartën e ndarjes së territorit në njësi:

- **Njësitë N6-1 dhe N6-2 dhe N3**, të cilat bëjnë pjesë në dy nënzona të PK njëkohësisht (ZQ dhe ZR), duhet të rikonfigurohen për të evituar mbivendosjet e veprimtarive të shkallëve të mbrojtjes, në mënyrë që njësitë të jenë homogjene për sa i përket treguesve zhvillimorë. Për të drejtuar zhvillimin e këtyre njësive, nevojitet hartimi i një **Plani të Detajuar të Zonave të Rëndësisë Kombëtare** (PDZRK), i cili do të përcaktojë treguesit e mundshëm dhe mënyrën e ndërhyrjes në to. Pra, PPV për këto njësi nuk mund të japë tregues zhvillimi, por duhet t'i shkrijë të treja në një njësi të vetme, ku orienton nevojën e hartimit të planit të sipërpërmendur.

Njësia N6-3 në nënzonën ZPQ të parkut, duhet të rishikohet duke respektuar shkallën e tretë të mbrojtjes së këtyre zonave. Për të drejtuar zhvillimin e saj, nevojitet hartimi i një **Plani të Detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare** (PDZRK), i cili do të përcaktojë treguesit e mundshëm dhe mënyrën e ndërhyrjes në zonë. Si më sipër, edhe për këtë njësi, PPV për këto njësi nuk mund të japë tregues zhvillimi, por duhet t'a shkrijë në një njësi të vetme me njësinë **N4** përreth, ku orienton nevojën e hartimit të planit të sipërpërmendur.

- **Për të gjitha njësitë pjesë të Zonës së Mbrojtur**, në tabelën e njësive në rregullore, duhet shtuar përshkrimi i përkatësisë së njësive në Parkun Kombëtar (shoqëruar me informacionin për nënzonën që i takon), veprimi i VKM-së përkatëse dhe përcaktimet e Planit të Menaxhimit, për menaxhimin dhe zhvillimin e posaçëm të njësive.

Me reflektimin e këtyre çështjeve, AKPT do të angazhohet për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë, në mënyrë që të vijohet me miratimin e PPV-së në Këshillin Bashkiak, dhe Këshillin Kombëtar të Territorit.

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptoi, punoi: B. Dindo

Datë: 30.12.2016

Nr. Kopje:2